**Republika e Kosovës**
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
***Kuvendi i Komunës Rahovec***
*Skupština Opština Rahovac/Municipality of Rahovec*

**01 Nr. 9/25**
**Rahovec, 12.9.2025**

Ftohen anëtarët e Kuvendit Komunal që të marrin pjesë në mbledhjen e **nëntë (9)**, e cila do të mbahet më **22 shtator 2025 (e hënë)**, me fillim në orën **10:00**, në sallën e KK Rahovec.

Për këtë mbledhje, propozoj këtë:

## R E N D   D I T E

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;
2. Pyetjet, përgjigjet dhe diskutimet e kuvendarëve;
3. Shqyrtimi dhe miratimi i vendimit për miratimin e buxhetit për vitin 2026;
4. Shqyrtimi i informatës për përgatitjen e vitit shkollor 2025/2026.

**KRYESUESI I KUVENDIT**

**Arbër Zenuni**

**Republika e Kosovës**
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
***Kuvendi i Komunës Rahovec***
*Skupština Opštine Orahovac / Municipal Assembly of Rahovec*

**PROCESVERBAL**

Nga mbledhja e rregullt e Kuvendit Komunal të Rahovecit, e mbajtur më **29.8.2025,** me fillim në orën **10:00**. Mbledhjen e kryesoi kryesuesi i Kuvendit, **Arbër Zenuni.** Në fillim kryesuesi konstatoi se kuorumi për mbajtjen e mbledhjes ekziston. Në fillim të mbledhjes, nga 31 anëtarë, të pranishëm kanë qenë 20.

**Kryesuesi:** Përshëndetje për të gjithë! I nderuari kryetar i Komunës, **Smajl Latifi**, nënkryetar **Fatmir Iska**, të nderuar anëtarë të Kuvendit Komunal, drejtorë të drejtorive komunale, zyrtarë komunalë, përfaqësues të KFOR-it, medie, të nderuar qytetarë të komunës së Rahovecit! Për këtë mbledhje të **tetë** me radhë të vitit 2025, së bashku me kryetarin, kemi vendosur për këtë rend dite:

**REND DITE**

1. **Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;**
2. **Pyetjet, përgjigjet dhe diskutimet e kuvendarëve;**
3. **Shqyrtimi dhe miratimi i vendimit për dhurimin e laptopave anëtarëve të Kuvendit të Komunës;**
4. **Shqyrtimi dhe miratimi i vendimit për miratimin e deklaratës për eliminimin e të gjitha formave të dhunës ndaj grave në politikë dhe në jetën publike;**
5. **Shqyrtimi i Planit të Veprimit për Zbatimin e Rekomandimeve të ZKA-së për vitin 2024;**
6. **Shqyrtimi i informatës për gjendjen e mbeturinave në komunën e Rahovecit;**
7. **Shqyrtimi i informatës rreth aktiviteteve për nder të Muajit të mërgimtarëve për vitin 2025;**
8. **Shqyrtimi i raportit për zbatimin e Planit të Integritetit, janar-qershor 2025.**

**Kryesuesi:** Të nderuar kuvendarë, kush është "për" këtë rend dite?... Kundër?... Konstatoj që unanimisht votohet rendi i ditës për mbledhjen e sotme.

1. **Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar:**

**Kryesuesi:** Nëse dikush ka diçka rreth procesverbalit nga mbledhja e kaluar?... Nëse jo, e vendosim në votim. Kush është "për"?... Unanimisht (20) aprovohet pika e parë e rendit të ditës.

2. **Pyetjet, përgjigjet dhe diskutimet e kuvendarëve:**

**Faton Ramadani:** Përshëndetje për të gjithë! Unë e kam një pyetje për drejtorin e Bujqësisë: Kullimi i tokave bujqësore në fshatin Celinë është një projekt që ka filluar qe dy vjet dhe së fundi, ka ngelur. Nuk e di, vitin e kaluar me 22/23 dhjetor punonin. Me këtë gjendje, bujqit nuk kanë qasje nëpër ara dhe është shumë e rëndësishme që këtij projekti t'i shkohet në skaj. Një problematikë tjetër rreth tatimit mbi pronë. Dje shkova të paguaj këstin e dytë të tatimit mbi pronë, e kam dokumentin këtu. Në fillim të vitit i kam pasur 95€, këstin e parë e kam paguar 47€ dhe tani kur shkova për këstin e dytë, i kisha edhe 66.79€, rreth 22.70€ më tepër. Nuk e di pse. Punëtorët aty nuk më jepnin përgjigje. Nuk ka mundësi, që drejtori i Financave të na japë ndonjë informatë. Si të veproj unë në këtë rast? A t'i paguaj këto 22€ më shumë, apo jo?

**Vlora Vuçiterna – Çmega:** Përshëndetje për të gjithë! Disa fjalë për arsimin në Rahovec: Është e papranueshme që në vitin 2025 fëmijët tanë të hyjnë në shkolla të papërgatitura. Pa kurrfarë plani dhe pa higjienë, sepse Drejtoria e Arsimit nuk i ka bërë detyrat elementare që i takojnë. Shkarkimi i drejtorit nuk mund të merret arsyetim, sepse arsimimi nuk ndalet me ndërrime karrigesh – dikush duhet të marrë përgjegjësi. Dy muaj e më shumë dhe asnjë ditë kushtuar nxënësve tanë dhe kjo ndodh vetëm në komunën tonë. Çështja e mjeteve higjienike është edhe më skandaloze. Si është e mundur që një kompani që paguhet me paratë e qytetarëve i furnizon shkollat dhe në anën tjetër produktet higjienike po avullohen për disa ditë? Kush po përfiton nga kjo pakujdesi, apo nga ky abuzim? Ndërkohë, fëmijët tanë mbesin pa kushte minimale higjienike. Kërkojmë sqarim të menjëhershëm dhe jo me email. Pse nuk janë bërë përgatitjet dhe shpjegojeni këtu, para publikut, se ku po zhduken këto mjete higjienike dhe e treta, kërkoj që të ndërmerrni masa konkrete dhe jo vetëm fjalë e justifikime.
**Sejfullah Sejfullahu:** Faleminderit, kryesues! Përshëndetje për juve, për kryetarin, drejtorët, kolegët, vëzhguesit, mediet! Është kohë fushate dhe nëse e bëj ndonjë kërkesë apo vërejtje, nuk shkon dhe nuk është në karakterin tim, sepse sa herë që kam kërkuar diçka, shumë pak ma keni vënë vëmendjen. E kam një diskutim të veçantë rreth larjes së rrugëve në Krushë. Ai djali që i lan rrugën nuk ka ardhur më dhe dua ta di se çfarë kontrate. Gjithashtu, 2-3 drita kanë mbetur pa u vënë në rrugën për xhami. Kryetar, në mandatin tuaj dëgjova që një kompani e ka bërë një projekt se si do të duket Krusha e Madhe, përafërsisht në 50 vitet e ardhshme, kompani e cila këtë projekt e ka marrë prej komunës në vlerë prej 17.000€. A ka ndonjë gjë të vërtetë dhe nëse po, a ka mundësi ta shohim, sepse më thanë që ideja ka qenë shumë e mirë.
**Kryetari:** Faleminderit, kryesues, drejtorë të drejtorive, anëtarë të kuvendit, përfaqësues të KFOR-it, LMT-së, medie! Te Faton Ramadani: Kompania herë pas here mund të mos punojë ndonjë ditë, por, është në fund që t'i krijojë qasje fermerëve aty, në kanalin e kullimit, Fortesë – Celinë. E dyta, Sefë, çdo shqetësim i paraqitur këtu, ne e marrim shumë seriozisht. Nuk e di sa herë e ka në kontratë që t'i lajë rrugët, por ju jap fjalën që do ta angazhoj kompaninë që t'i lajë rrugët edhe nëse nuk e ka në kontratë. Përparim, bisedo me Sefën për këtë çështje. Te ndriçimi publik, ka investime të mëdha këtu, pothuajse gjithkah. Në situata ku nuk ka shtylla, pak e kemi më të vështirë. Sa i përket atij projektit që e përmende, nëse është projekt i Ramadan Gashit?... Atëherë qenka diçka tjetër! Ramadan Gashi e ka angazhuar një ekspert shqiptar nga Franca, kjo bëhet fjalë për mandatin e parë. Nëse bëhet fjalë për atë projekt për Krushën, i cili është i mirë dhe voluminoz, si dhe do të gjejë zbatim përmes investitorëve privat dhe jo përmes sektorit publik. Në qoftë se bëhet fjalë për Agim Sejfullahun, nuk kam informata. Para seancës, sot e kemi mbajtur takimin me drejtorë të shkollave, koordinatorë të cilësisë dhe kryetarë të këshillave drejtues dhe salla e kuvendit pothuajse ka qenë plot. Pse s'e keni mbajtur më herët? Ka një muaj e gjysmë, që i ngarkuari me punë të arsimit, drejtori Afrim Limani që është duke u marrë me punë dhe me drejtorë të shkollave. Sa i përket kontratës së higjienës, nuk kemi kontratë aktive, sepse lënda është në OShP. Deri sa të kthehet lënda, ligjërisht deri 99€ ata kanë të drejtë të marrin material higjienik. Sa i përket zhdukjes së materialit higjienik, ju lutem, nëse ka situata të tilla, atëherë është puna për në polici, vetëm na duhen informatat dhe unë i bashkohem secilit që ka ndonjë situatë konkrete.
**Rasim Fazliu:** Përshëndetje për të gjithë të pranishmit në sallë! I kam disa pyetje: Pyetja e parë lidhet me rrugë. Është fjala për rrugën që e kemi diskutuar disa herë, prej Piskajut që del në atë rrugën e asfaltuar, prej Fortesës që shkon te "mella" dhe më keni thënë që "do të bëhet", "do të bëhet". Nuk kemi asgjë konkrete deri më tani edhe pse këtë çështje e kam ngritur në disa mbledhje radhazi. Kur do të bëhet? Tjetra, është për drejtorin Përparim. Deri ku keni arritur në rrugën Fortesë – Celinë dhe kur do të fillojnë punimet? Një shqetësim tjetër e kam nga unë vetë personalisht, por edhe nga qytetarët. Kompanitë e rrjeteve dhe ajo që i ka ndërruar shtyllat elektrike e ka kryer punën e vet, mirëpo, prej asaj kohe deri më sot nuk i kanë kyçur dritat në një pjesë të fshatit. U kam thënë atyre se pse nuk po i kyçni, më thanë që nuk është kompetencë e jona, por e komunës. Shqetësimin e pata në atë që ka shumë kabllo të varura dhe jashtë përdorimit, si dhe po e japim një shije të keqe. Drejtor, është mirë që t'u drejtoheni kompanive që t'i largojnë të gjitha kabllot që nuk duhet.

**Përparim Krasniqi:** Faleminderit! Përshëndetje kryetar, anëtarë të Kuvendit, monitorues të seancës. Po, baca Rasim, është e vërtetë që KEDS-i është duke bërë zëvendësimin e të gjitha shtyllave. Mirëpo, KEDS-i nuk e ka treguar një të vërtetë tjetër, e ka këputur edhe kabllon dhe në momentin që e sjell kabllon, ne i zëvendësojmë të gjitha poçet elektrike. Rruga Fortesë – Celinë, është në procedurë në prokurim publik deri më 15 shtator dhe në momentin që përfundon do të lidhet shumë shpejt kontrata dhe do të vazhdojmë me punime.
**Kryetari:** Aktualisht, Berati po mungon, sepse po vazhdon trajtimi i një rruge fushore në Rahovec. Kompania është e fortë, por ndoshta nuk po arrin t'i plotësojë pritjet, të cilat natyrshëm i kemi. Pra, kontratë për rrugë fushore kemi edhe pse kërkesat nuk janë të vogla.
**Rasim Fazliu:** Kryetar i nderuar, nuk po flas për sivjet dhe nuk dua të kritikoj, sepse s'jam i prirë të kritikoj, por në Celinë jemi shumë prapa me rrugë fushore, qe 10 vjet, jo qe 1 vjet. Unë jam dëshmitar, e kemi edhe Afrimin, por edhe ti e di, sepse e njeh Celinën në pëllëmbë, aty nuk kemi rrugë të ndrequr asnjëherë. Kështu që, që 10 vjet presim dhe nuk është bërë diçka e veçantë për Celinën. Në të gjitha anët po punohet, unë ju përgëzoj, por gjithashtu është mirë të shkoni pak me proporcion.
**Kryetari:** Unë e mirëkuptoj Rasimin, por, do të ishte më e drejtë dhe më objektive të thotë që ndoshta ka më pak investime në rrugë fushore, jo që 10 vjet. Unë e mbaj në mend këtu, bashkë me Rasimin dhe kemi ndërhyrë në disa rrugë fushore. Çështja është që nëse ka pasur pak angazhime në rrugë fushore në atë anë, nuk është që kanë munguar investimet e tjera kapitale. Një rrugë që e përmende, e di për cilën është fjala. Ajo rrugë është në këtë projekt dhe në rastin e parë besoj që do të ketë investim.
**Lirigzon Kastrati:** Faleminderit, kryesues! Të nderuar anëtarë të ekzekutivit, anëtarë të Kuvendit, përfaqësues të KFOR-it, qytetarë të komunës së Rahovecit. Në seancën e kaluar dhe në seancat e tjera, nga Drejtoria e Bujqësisë kemi kërkuar që të na dërgojë listën e të gjitha rrugëve fushore që kjo drejtori ka intervenuar në secilin fshat. Po thonë që kemi bërë rrugë fushore dhe ne duhet t'i dimë se cilat. Te Drejtoria e Financave gjithashtu kemi bërë pyetje dhe shpresoj që në këtë seancë do të përgjigjet. Për Drejtorinë për Mbrojtje dhe Shpëtim, drejtoreshën Besë: Komuna tani ka pasur telashe me çështjen e zjarrit dhe disa bujq janë dëmtuar. A e keni bërë ndonjë komision për konstatimin e këtyre dëmeve dhe të shikohet me mundësi të kompensimit. Herën e fundit, në Hoçë të Vogël dhe Brestoc e kemi pasur një zjarr të madh dhe disa bujqve u janë dëmtuar edhe vreshtat.
**Merisa Sharku:** Përshëndetje për të gjithë! Sa herë që e kam marrë fjalën që të diskutoj rreth projekteve në komunën tonë, kërkesa më specifike ka qenë: ndërtimi. Gjithmonë e kam cekur se më e rëndësishmja te një projekt është zbatimi i detajeve gjatë ndërtimit. Në komunën tonë, kjo gjë nuk përfillet. Shtrohen rrugët dhe pas një muaji gropohen që të nivelizohen pusetat. Kur projektet projektohen nga komuna, krijohet sheshi si qendra e qytetit, që u krijua në një vend "fatkeqësisht" për qytetarët me aksidente të shumta në atë pjesë dhe tollovinë e përditshme, si dhe njerëzit po mendojnë që sheshi në qendër ende nuk ka përfunduar. Kur projektet, të mos them vidhen, apo huazohen si puna e Grapelandi-it, prapë prishen e zbatohen në versionin "mazamakeq". Një tjetër projekt si i vetmi i organizuar në konkurs të nivelit ndërkombëtar dhe konkurs i përmasave serioze – sheshi qendror i qytetit, përsëri në fund rezultati i njëjtë – ndërtim me shumë defekte. Një shesh i mirëfilltë duhet ta ketë një organizim të tillë të konkursit, mirëpo, çdo herë frika që zbatimi do të jetë i keq – ashtu siç është në çdo projekt të qytetit. Pse projekti zbatues i sheshit po ka kaq vështirësi që të ketë qasje prej qytetarëve? Pse projektin zbatues nuk e bëni publik në faqen ueb të komunës, sepse kërkesa prej qytetarëve është shumë e madhe, që ta shohin se çka do të bëhet në fund?! A është e paraparë që në shesh të mbahen evenimete të mëdha, të përmasave si të "Hardh Festit", sepse kështu kemi dëgjuar. Nëse aty futemi me pashë më të madhe, qoftë me njerëz apo makineri, a e keni bërë analizën e tokës, analizën e hekurit dhe betonit që po e shtroni aty. Hiç më larg se dje – pardje, është shtruar një shtresë e hollë e betonit dhe nën të e pashë vetëm një rrjetë të armaturës. A është e qëndrueshme ajo tokë dhe ajo shtresë që po e shtroni, në atë pjesë ku do të bëhen kubëzat e sheshit? Këto përgjigje dëshiroj t'i dëgjoj prej drejtorit, sepse dje e pashë një reagim të tij në rrjetet sociale. Drejtori po mbahet në atë që projekti është i bërë nga ndërkombëtarët. Në rregull, por zbatojini të gjitha

rekomandimet e tyre, sepse së fundmi e pashë që asnjë arkitekt që e ka projektuar sheshin, nuk po konsultohet nga komuna.

**Albnor Mullabazi:** Faleminderit, kryesues! I nderuari kryetar, kolegë drejtorë, asambleistë, të pranishëm! Sa i përket pyetjes së Merisës, askush nuk mund ta mohojë që sheshi qendror ka qenë me konkurs ndërkombëtar dhe për këtë gjë i kemi edhe vlerësimet prej UN HABITAT, që ka qenë bashkë me ne në këtë konkurs. Prej 37 shteteve kanë qenë mbi 80 aplikime dhe nga juria profesionale është zgjedhur projekti më i mirë. Sot, njëri nga anëtarët e jurisë është kryetar i Prishtinës, arkitekti Përparim Rama. E kemi pasur edhe një arkitekt tjetër vendor, Dashnor Kadiri. Në bazë të kësaj, projekti kryesor është punuar nga kompania për hartimin e projekteve, e cila është e kontraktuar nga komuna. Puna në sheshin qendror po vazhdon në bazë idesë që e kemi nga konkursi ndërkombëtar. Në muajin maj, jam takuar me njërin prej arkitektëve dhe ai ka qenë shumë i kënaqur me punën që po bëhet në shesh dhe që jemi duke iu përmbajtur konceptit të projektit ideor. Sa u përket analizave, i kemi të gjitha llojet e tyre, matjet në laborator dhe çdo raport të situacionit. Projekti i sheshit është në fazën finale dhe shumë shpejt do të fillojmë t'i vendosim edhe pllakat. Sa i përket organizimit të Hardh Festit, e mirëpresim vitin e ardhshëm në qytet. Sa i përket projektit të Ballkonit Panoramik, është e vërtetë që ka pasur një ide prej të rinjve në atë kohë dhe gjithashtu janë takuar me kryetarin. Këta, në mandatin e kaluar e kanë dorëzuar një kërkesë në emër të OJQ-së "Grapeland", ku kanë kërkuar që ajo tokë të kalojë në emër të OJQ "Grapeland". Në përgjigjen e marrë nga Drejtoria e Urbanizmit, u është kërkuar që ta sjellin projektin për Ballkonin Panoramik dhe t'i vazhdojmë procedurat, por ata nuk e kanë sjellë asnjëherë projektin në Komunë të Rahovecit. Në bazë të kësaj, Komuna e Rahovecit, në vitin 2022, e ka fituar një grant prej ministrisë dhe me kompaninë për hartimin e projekteve e ka hartuar projektin e ballkonit panoramik. Merisë, ti ke qenë pjesë e atij grupi dhe projekti i tanishëm ka dallim të madh nga projekti i juaj. Ju nuk keni sjellë asnjëherë projekt në komunë dhe për këtë kemi dëshmi. E kemi njoftimin nga Drejtoria e Urbanizmit, që iu është dërguar në mandatin e kaluar për projekt dhe asnjëherë nuk ka ardhur projekti. Në atë kohë në kërkesën e "Grapeland" është kërkuar që prona të kalojë në emër të titullarit të OJQ-së.
**Kryetari:** Faleminderit! Të përgëzoj për përgjigje. Përgjigje e saktë për sheshin qendror. Unë e di që tani bëhet zhurmë, sepse e kuptoj kohën ku jemi. Atyre iu kam thënë që ta sjellin projektin, por, nuk e kanë dorëzuar kurrë. Drejtori e harroi që, ne e kemi shfrytëzuar një thirrje të MZhR-së, sepse në mungesë të projektit, në atë vend kemi dashur që të bëhet diçka. Merisa është zonjë e nderuar dhe nuk është mirë të bie në një lloj debati, që realisht është totalisht i pabazuar në fakte, sepse asnjëherë nuk ka pasur projekt dhe çdo tentativë për zhurmë (jo nga ti) është e kotë. Ne jemi të lumtur që e kemi fituar projektin, sepse kemi mundur të mos e fitojmë. Nëse do të kishte projekt: Smajl Latifi, ish-drejtori Rumir Zhuniqi dhe drejtori Albnor, menjëherë 100% do ta miratonim. Dikush që nuk është këtu hiç, nuk e di, ai ka bërë zhurmë edhe për shesh. Nuk duhet të koncentrohet vëmendja e opinionit në një djalë që ka ide, ka kreativitet dhe tani krejt qyteti të merret me të. Sot e ftoj, përsëri e ka idenë hapur dhe çfarëdo ide të niset dhe të zhvillohet, sepse është krenari të fillohet një ide. Sa i përket sheshit në qendër. Këtu iu kam thënë: Aty do të diskutohet objekti ekzistues i kulturës, për shkak të qendrës për inovacion këtu. Mendoj që qyteti ka funksionuar mirë, ndoshta edhe për shkak të rrugëve alternative. Ne kemi qenë edhe në qytetet fqinje dhe i kemi bërë 2 orë të rrugës për Prizren, 3 orë për në Prishtinë etj. Mendoj që Rahoveci është mirë me komunikacion dhe nëse dikush nuk i zbaton shenjat e trafikut, atëherë aty ka punë policia. Nëse ka nevojë që projekti i sheshit në qendër të plotësohet, mund të plotësohet ndoshta nesër kur të intervenojmë në shtëpinë e kulturës. Sa u përket punimeve, çdo vit ka përmirësime edhe në kualitet të punimeve.
**Afrim Limani:** I nderuari kryesues, kryetar, nënkryetar, asambleistë! Lirigzoni, në seancën e fundit e ka parashtruar pyetjen se, sa është vlera e mjeteve të tërhequra për kontratën kolektive dhe për urdhrat e tjera përmbarimore. Deri më sot, vlera e mjeteve të tërhequra nga thesari për urdhra përmbarimore në total është 2.293.000. Nga kjo vlerë,

242.000 janë të tërhequra për operatorë ekonomikë, ndërsa për kontratën kolektive në arsim janë 2.050.000€. Sa për dijeninë tuaj, para 20 minutave na morën edhe 70.000€. Te raporti, më detajuar: Tërheqja për zbatimin e kontratës kolektive ka filluar nga viti 2021 dhe vlera e tërhequr ka qenë 8268€. Në vitin 2022 ka qenë 173.400€. Në vitin 2023 ka qenë 815.000€. Në vitin 2024 ka qenë 1.613.000 dhe ndërsa tani janë 2.120.000€. Deri më tani, vlera e ngarkesës është 5.848.000 dhe janë paguar 4.661.000, ndërsa kanë ngelur edhe 1.110.000€.

**Besmire Bytyqi:** Faleminderit kryesues! Të nderuar anëtarë të kuvendit! Lirigzon, faleminderit për pyetjen. Vetëm në muajin korrik i kemi pasur diku 80 zjarre, deri sot në muajin gusht i kemi 60 zjarre. Kemi pasur edhe dëme në kultura bujqësore, posaçërisht në vreshta. Secili person që ka sjellë kërkesë në Komunën e Rahovecit, ne e kemi komisionin që është 4-vjeçar dhe ka dalë në terren për verifikimin e gjendjes. Fillimisht, bëhet ankesa në polici, policia e thërret inspektoratin e zjarreve dhe më pas sillet kërkesa në komunë. Nëse ke ndonjë pyetje, ose t'i ndihmojmë dikujt, jemi këtu.

**Sejfullah Sejfullahu:** Jam shumë i kënaqur me ekipin e zjarrfikësve, sepse kanë bërë punë të mirë duke rrezikuar edhe jetën e tyre, sidomos herën e fundit në Krushë.

**Hasan Përboqi:** Përshëndetje kryesues, nënkryetar, kolegë asambleistë, drejtorë, medie, përfaqësues të LMT-së, qytetarë! Fjalën e mora për t'i diskutuar projektet në qytet dhe veçanërisht për një projekt që ka filluar së fundmi dhe ka një kohë të gjatë që banorët kanë qenë në pritje të realizimit. Bëhet fjalë për asfaltimin e rrugës "Bekim Isma" dhe në një pjesë të saj edhe zgjerimin. Rruga "Bekim Isma" është në pjesën e epërme të qytetit dhe fillon prej xhamisë deri në dalje të qytetit kah Suhareka. Ky investim besoj që do të ndikojë shumë, që banorët e asaj ane ta kenë më të lehtë lëvizjen, qoftë me vetura apo edhe në këmbë. Në emër të banorëve, e shfrytëzoj rastin t'ju falënderoj për këtë rrugë dhe njëkohësisht është një kërkesë e banorëve që, pasi të përfundojë asfaltimi në atë rrugë, të vendosen pengesa fizike, që ndikojnë në ngadalësimin e shpejtësisë së lëvizjes së veturave. Është kërkesë specifike që pengesat të jenë të asfaltit, sepse këto të gomës, pas një kohe të shkurtër, po dëmtohet dhe shtohet nevoja që prapë të investohet. Kërkesa tjetër është e një familjeje që është shumë e rrezikuar nga shembja e një rruge tjetër, që është në afërsi të rrugës "Bekim Isma". Bëhet fjalë saktësisht për familjen Iballi dhe aty ka nevojë të ndërtohet një mur mbrojtës, sepse kjo është nën nivelin e rrugës dhe shkaku i mungesës së murit, rrezikohet që të shembet dheu mbi shtëpinë e asaj familjeje.

**Defrim Kafexhiu:** Faleminderit, kryesues! Përshëndetje për nënkryetarin, drejtorët, kolegët anëtarë të Kuvendit komunal. Me vëmendje e dëgjova çdo diskutim, kërkesë apo kritikë kundrejt ekzekutivit, si dhe përgjigjet e ekzekutivit drejt atyre pyetjeve. Është për t'u vlerësuar, edhe pse jemi në fund të mandatit, ky kuvend e ka pasur këtë aktivitet përgjatë të gjithë mandatit, deri tani në fund. Unë për vete ndihem krenar që jam pjesë e këtyre njerëzve dhe në mesin e këtyre njerëzve që vazhdimisht kanë shprehur pakënaqësi kundrejt ekzekutivit dhe që kanë pasur kërkesa për interes të qytetarëve. Përderisa nuk është publikuar projekti i sheshit qendror, sa do të ketë hapësira të gjelbra brenda sheshit? Meqenëse është edhe fushata zgjedhore, ka fjalë edhe prej partive të tjera që do ta ndryshojnë që t'i shtojnë disa hapësira të gjelbra. Nuk e dimë saktë sa hapësira të gjelbra do t'i ketë sheshi qendror. Një përvojë jo të mirë e kemi sheshin në qendër, që pothuajse hiç nuk ka hapësira të gjelbra, vetëm pllaka prej betoni. Kjo gjendje, nuk besoj që përkon me kohën ku jetojmë dhe nuk është më e mira e mundshme që mund të bëhet për qytetarët që i shfrytëzojnë këto hapësira publike. Një pyetje tjetër e kam për pemët që janë të mbjella përskaj rrugëve kryesore. Nuk e di përgjegjësi e cilës drejtori është, por është mirë që drejtori i Urbanizmit të ketë pak vëmendje. Pemët, nëse nuk gaboj, ka rreth 8 vjet që janë të mbjella dhe kur është koha e krasitjes, pemët po krasiten deri në fund dhe nuk rriten. A janë mbjellë pemët për të krijuar hije dhe zbukurim, apo që çdo vit t'i kthejmë aty ku kanë filluar?! Te shërbimi i shkurtimit të këtyre pemëve, nëse nuk gaboj, është duke e kryer Ekoregjioni.

**Albnor Mullabazi:** Faleminderit Defrim për pyetjet! Sa i përket pjesës së sheshit dhe partitë politike e kanë atë punë që çdoherë t'i gjuhen të fortit. Koncepti i fjalës shesh, është hapësirë e shtruar me pllaka, beton apo kalldrëm. Ndërsa koncepti i parkut është hapësirë e gjelbëruar. Brenda hapësirës së sheshit e kemi parkun, i cili do të jetë me gjelbërim.

Brenda unazës së sheshit janë dy oaza dhe tre fontana me ujë, si dhe jashtë rrethit të sheshit ka ishuj gjelbërues, të cilët shumë shpejt do të mbushen me pemë. Brenda sheshit është edhe këndi i lodrave. Sa i përket projektit të sheshit, për shkak të volumit të madh nuk e kemi postuar, kushdo që është i interesuar mund të vijë në zyrë që ta shohë. Projektin e kanë marrë edhe përmes qasjes në dokumente zyrtare.

**Merisa Sharku:** Rekomandimi im është që në parkun e qytetit të shtohet gjelbërimi, që të fitohet balancimi me pjesën e betonizuar që e përmende në shesh.

**Përparim Krasniqi:** Defrimi pyeti rreth drunjve dekorativë dhe është kompetencë e Shërbimeve Publike. Arsyeja pse nuk rriten ata drunj është për shkak të konfiguracionit të qytetit. Rrugët janë të ngushta dhe bëhen pengesë për banorë. Tjetra, drunjtë e mbjellë nuk janë drunj që duhet të rriten, sepse një frymë apo një shi mund të ketë thyerje të degëve dhe e kemi si rekomandim nga ekspertët bujqësorë, që krasitja të bëhet në sezonin pranveror. Këta drunj më shumë janë dekorativë.

**Defrim Kafexhiu:** Nuk është Rahovecit qyteti i vetëm me këta drunj dekorativë dhe që nuk po i lejoni të rriten! Është non sens, atëherë ndërrojeni llojin dhe jo ashtu si "cunga"! Nëse këto pemë nuk janë të rritura, nuk janë dekorative, por janë pengesë.

**Përparim Krasniqi:** Nuk janë si cunga, janë goxha të gjelbëruara në qytet dhe krasitja bëhet në suaza normale. Janë projekte të financuara nga Bashkimi Evropian.

**Ilir Pallqa:** Faleminderit, kryesues! Përshëndetje për të gjithë! Meqenëse ishte fjala për parqe. Te shkolla "Sadedin Hajda", në anën e djathtë të shkollës, është një parcelë, më duket është hapësirë publike dhe drejtori i Gjeodezisë duhet të jetë në dijeni. Aty, ajo tokë ka mbetur si deponi ilegale dhe ajo lagje ka mjaftueshëm shtëpi që ta meritojë një park, si dhe një vendqëndrim për të moshuarit. Është lagje në rritje, sepse vazhdimisht po ndërtohen shtëpi të reja.

**Kryetari:** Po, Ilir, sa u konsultova me drejtorin dhe më tha që është në proces të shpronësimit dhe është nën menaxhim të AKP-së dhe shpresojmë që të kemi përgjigje pozitive.

**3. Shqyrtimi dhe miratimi i vendimit për dhurimin e laptopave anëtarëve të Kuvendit të Komunës:**

**Kryetari:** Të nderuar anëtarë të Kuvendit, ju e dini që, sipas kontratës, duhet ta keni secili nga një laptop dhe meqë jemi në fund të mandatit, duhet ta sqarojmë situatën për shkak të aseteve dhe auditorit. Po marrim vendim për faljen e laptopëve dhe nëse jeni "për" ju ftoj të votoni.

**Ilir Pallqa:** Laptopët që i kemi marrë prej komunës na shërbejnë për punët tona në Kuvend, aty i pranojmë emailat, i marrim njoftimet, i përgatisim fjalimet dhe ndonjëherë e përdorim edhe për gjeoportal. Këta laptopa që i kemi, janë pajisje që pa problem mund të përdoren edhe në mandatin e ardhshëm për këto funksione (jo për video e montime). Nuk ka arsye që të kthehen në dhurata personale, sepse janë blerë me buxhetin e banorëve të Rahovecit dhe mos të harrojmë që, pagat tona janë shumë më të larta se atëherë dhe me një pagë mujore, kush ka interes, mund ta blejë një super-laptop. Një pjesë e madhe e asambleistëve, as nuk i kanë përdorur laptopat për punë komunale, por veç për punë të tyre. Unë po insistoj që këta laptopa të mbesin pronë e komunës dhe që nesër t'i gëzojnë asambleistët fitues. Kështu e kursejmë buxhetin dhe si simbolikë i dënojmë pak asamblesitët që nuk kanë qenë të përgjegjshëm as me prezencë në seanca, as me pjesëmarrje në ngritje të shqetësimeve komunale.

**Kryetari:** Unë e mirëkuptoj sensitivitetin e kësaj teme dhe e kuptoj atë që është publike. Ju jeni njerëz publikë dhe të zgjedhur. Gjithashtu, besoj që laptopat që i keni sot, nuk jam i sigurt a mund të përdoren nesër, për shkak të dinamizimit të teknologjisë. Unë jam "për" që këto asete me vendim të Kuvendit komunal t'i merrni ju, sepse nuk e di, nëse nesër shpallim ankand, ndoshta nuk i blen askush dhe atëherë do të bëheshin për deponim inerte.

**Defrim Kafexhiu:** Unë kam qenë në pozicionin e kryesuesit kur këta laptopë janë blerë dhe janë dorëzuar tek anëtarët e Kuvendit dhe për mua ka qenë normale që t'ju ofrojmë kuvendarëve pajisje, që ndikojnë në lehtësimin e punës së tyre. Atëherë e kam menduar që duhet t'ju falim, që të jetë një dhuratë modeste ose një kujtim që e kemi pasur njëherë dikur një pozicion prej komunës së Rahovecit. Iliri tani kur foli, mendja pak po më ndërron. Është e vërtetë që unë rrallëherë në seanca e kam marrë pajisjen, por kjo nuk do të thotë që kam qenë pasiv dhe po ashtu ka

anëtarë të tjerë që e kanë marrë pajisjen dhe nuk kanë qenë aktivë. Nuk e di, jam me një mes, por do të jem me shumicën.

**Kryesuesi:** Atëherë, po e vendosim në votim. Kush është "për"?... Kundër?... Abstenim?... Me 17 vota pro, 2 kundër dhe 1 abstenim, aprovohet pika e tretë.

**4. Shqyrtimi dhe miratimi i vendimit për miratimin e deklaratës për eliminimin e të gjitha formave të dhunës ndaj grave në politikë dhe në jetën publike:**

**Kryesuesi:** Të nderuar anëtarë të Kuvendit, para jush e keni miratimin e deklaratës për eliminimin e të gjitha formave të dhunës ndaj grave në politikë dhe në jetën publike, që është miratuar në Kuvendin e Republikës së Kosovës, më datë 19 nëntor 2024. Po e lexoj një komunikatë mbështetëse mbi deklaratën për eliminimin e të gjitha formave të dhunës ndaj grave: "Ne, politikanët dhe politikanet, nëpunësit civilë dhe përfaqësuesit e shoqërisë civile të mbledhur në frymën e solidaritetit dhe të qëllimit të përbashkët, përmes kësaj deklarate, shprehim mbështetjen tonë të plotë mbi deklaratën për eliminimin e të gjitha formave të dhunës ndaj grave, në politikë dhe në jetën publike. U bëjmë thirrje të gjitha niveleve të qeverisjeve, për zbatimin kuptimplotë të dispozitave të kësaj deklarate. Me nënshkrimin e kësaj komunikate mbështetëse, ne rrisim zërin e deklaratës së 19 nëntorit të vitit 2024." A kemi ndonjë diskutim apo koment?... Nëse jo, e vendosim në votim. Kush është "për"?... Konstatoj që unanimisht votohet pika e katërt e rendit të ditës.

**Defrim Kafexhiu:** Faleminderit, kryesues! Te kjo pikë e pashë të arsyeshme të flas, të paktën disa fjalë. Sot, jemi mbledhur për të diskutuar dhe miratuar një deklaratë me rëndësi të veçantë – eliminimin e të gjitha formave të dhunës ndaj grave në politikë dhe në jetën publike. Kjo nuk është thjesht një çështje politike apo ligjore, por mbi të gjitha është një çështje e dinjitetit njerëzor, e drejtësisë dhe e demokracisë. Dhuna ndaj grave, në çfarëdo forme që shfaqet, qoftë ajo verbale, psikologjike, institucionale apo fizike, është një plagë e rëndë në shoqërinë tonë. Ajo dëmton jo vetëm gratë që janë viktima të saj, por edhe familjet tona, komunitetin dhe demokracinë që përpiqemi të ndërtojmë me përkushtim. Një shoqëri nuk mund të pretendojë se është demokratike, nëse gjysma e saj nuk ndihet e lirë, e barabartë dhe e respektuar. Politika dhe jeta publike duhet të jenë hapësira ku çdo qytetare e qytetar mund të kontribuojë lirisht, pa frikë dhe pa paragjykime. Përfaqësimi i grave në vendimmarrje nuk është vetëm një e drejtë themelore, por është edhe një pasuri për proceset demokratike, sepse sjell perspektiva të ndryshme dhe vendime më gjithëpërfshirëse. Miratimi i kësaj deklarate është një hap i rëndësishëm në drejtimin e duhur. Por le të mos mbetet vetëm në letër. Ne duhet të angazhohemi që ta zbatojmë në praktikë, duke ngritur mekanizma të qartë institucionalë për parandalimin dhe adresimin e rasteve të dhunës, duke ofruar mbështetje për viktimat dhe duke ndëshkuar çdo formë diskriminimi apo kërcënimi. Si përfaqësues të qytetarëve, kemi detyrimin moral dhe ligjor të garantojmë një ambient politik dhe publik të sigurt, ku gratë të marrin pjesë pa pengesa, të shprehen pa frikë dhe të kontribuojnë me gjithë kapacitetin e tyre. Të nderuar kolegë, sot, me këtë votim, kemi mundësinë të japim një mesazh të fuqishëm se në komunën tonë nuk ka vend për dhunë, se gratë dhe burrat janë të barabartë dhe se demokracia jonë forcohet vetëm kur të gjithë ndihen të përfaqësuar dhe të respektuar. Prandaj ju ftoj të gjithë që ta mbështesim këtë deklaratë pa hezitim. Le ta bëjmë këtë hap së bashku për një shoqëri më të drejtë, më të barabartë dhe më demokratike. Fatkeqësisht, këtë fjalim është dashur ta lexojë dikush nga gratë e Kuvendit, por unë u detyrova që të dal, sidomos kur jemi para një procesi zgjedhor, ku gratë e kanë një rëndësi shumë të veçantë në vendimmarrje, por edhe në përzgjedhjen e institucioneve për mandatin tjetër.

**Fahrije Lushi:** I nderuar kryesues, kryetar, kolegë këshilltarë, të pranishëm! Më bëhet qejfi që para nesh e kemi një deklaratë të tillë, e cila mundohet t'i flasë edhe ndërgjegjes më të ligë. Gratë nuk janë objekt i talljeve dhe i përbuzjeve, po ato janë më të fuqishme se asnjëherë dhe kanë fuqi në vendimmarrje për çdo proces që i nevojitet vendit. Po e nënvizoj Defrimin pak, i cili u shpreh shpejt. Dikush e shpreh në një mënyrë, e dikush në tjetrën, sepse nuk ka grua në këtë Kuvend që nuk është një zë i fuqishëm.

**Sejfullah Sejfullahu:** Faleminderit, kryesues! Përshëndetje për të gjitha gratë e botës. Unë i dua shumë gratë dhe herën e kaluar kur e kemi pasur këtë temë, e kam recituar një poezi që ia kam kushtuar gruas time. E kam një ide kryesues, kur të shkojmë në vizitë studimore si ide do të ishte mirë që t'i marrim edhe gratë me vete, përfshirë edhe kryetari.
**Merisa Sharku:** Pajtohem me parafolësit. Defrim, më shumë ka fuqi kur kërkesa dhe ndërgjegjësimi vjen nga burrat, sepse diskriminimi dhe shkelja më e madhe ndaj grave, vjen pikërisht nga burrat. Jam e lumtur që sot po e miratojmë këtë deklaratë dhe ndoshta kam qenë prej të paktave femra të Kuvendit që ka marrë pjesë në shumicën e tubimeve të organizatave të ndryshme.
**Kryetari:** Sefën dhe Fahrijen e kuptova, por Defrimin jo. Defrimi së pari duhet të fejohet dhe tutje ta kuptojë këtë punë. Kur të fejohesh e martohesh, do të avancosh dhe veprimet do t'i bësh në atë se çka të thotë gruaja.
**Kryesuesi:** Faleminderit për diskutimet. Pikën e vendosim në votim. Kush është "për"?... Unanimisht votohet pika e katërt e rendit të ditës.
**5. Shqyrtimi i Planit të Veprimit për Zbatimin e Rekomandimeve të ZKA-së për vitin 2024:**
**Afrim Limani:** I nderuar kryesues, nënkryetar! Të nderuar asambleistë, ashtu siç e dini edhe ju, raporti financiar për vitin 2024 ka rezultuar si opinion i pamodifikuar dhe nga ky plan kanë dalë 6 të gjetura. Konsideroj që nga këto 6 rekomandime, 4 prej tyre do të jenë të zbatueshme, ndërsa 2 pjesërisht dhe tutje besoj që do të zbatohen. Sipas ligjit kemi vepruar me kohë, sepse brenda një muaji, plani i veprimit për zbatimin e rekomandimeve duhet të dorëzohet. Kemi formuar komisionin për zbatimin e rekomandimeve me 13 anëtarë, i kemi mbajtur 2 mbledhje të rregullta dhe rekomandimet i kemi dërguar në kuadër të zyrave të ZKA-së.
**Lirigzon Kastrati:** Drejtori tha që me këtë plan, mbi 50% të rekomandimeve do të zbatohen. Çka do të bëhet me 50%-shin tjetër të rekomandimeve? Në këtë raport, sa rekomandime janë të përsëritura dhe në cilat raste nuk janë zbatuar rekomandimet?
**Defrim Kafexhiu:** E kam një kritikë për anën tjetër tani, sepse ndoshta jeni lodhur duke e kritikuar ekzekutivin. Një kritikë për kolegun e kuvendit, Lirigzon Kastrati. Raportin e kemi në material dhe këto pyetje që i bëre, vetëm është dashur ta shfletosh pak materialin dhe t'i konstatosh vetë rekomandimet dhe kundrejt drejtorit të Financave ta japësh një kritikë për produktive. Lirigzon, respekt!
**Lirigzon Kastrati:** Tash po e kuptoj se me kë e ka fushatën zgjedhore, Defrimi! Ne edhe në seancën e kaluar kemi pasur të diskutojmë për raportin e auditorit, por, drejtori ka munguar. Ti e ke përshëndetur vendimin tonë, Arbri gjithashtu na ka uruar rrugë të mbarë, por, një gjë duhet ta dini, qytetarët dhe partitë politike është mirë mos t'ju thonë "rrugë të mbarë", sepse për veprimet tona politike jemi të vetëdijshëm.
**Sejfullah Sejfullahu:** Më kujtohet në fillim, kur raporti ka qenë me shumë vërejtje dhe rekomandime. Më kujtohet edhe emri i saj, Vlora Spanca. Dyshoj që na është bërë e padrejtë, por sidoqoftë, po e shoh që çdo vit po zvogëlohet numri i rekomandimeve nga ZKA-ja. Kjo gjendje, besoj që është si rezultat i presionit të opozitës kundër jush dhe ju keni punuar pak më mirë.
**Kryetari:** Është e vërtetë që e kemi një plan të zbatimit të rekomandimeve. Numri i rekomandimeve po rritet dhe gjithashtu auditori si institucion kushtetues e i pavarur, e ka të drejtën ekskluzive për vlerësim. Fatkeqësisht, problemin më të madh si keqklasifikim është duke na shkaktuar kontrata kolektive, jo vetëm neve, por plot komunave. Presioni i opozitës ka qenë aktiv, por gjithashtu edhe presioni i rritjes së përgjegjësisë së ekzekutivit, sepse një e gjetur e auditorit është subjekt i prokurorisë. Kosova ende nuk ka arritur në atë pikë, që një raport i komunës të jetë pa asnjë rekomandim. Përkundër kësaj, Kosova ka shënuar hapa progresivë të jashtëzakonshëm dhe kush e mohon "nuk është në tokë të bukës"! Për 15 vjet ka ndryshime të mëdha epokale.
**6. Shqyrtimi i informatës për gjendjen e mbeturinave në komunën e Rahovecit:**
**Përparim Krasniqi:** Faleminderit, kryesues! Përshëndetje për anëtarët e Kuvendit! Gati në çdo seancë kemi pasur raporte apo informata për hapësira publike, rreth menaxhimit të mbeturinave. Para jush e keni gjendjen momentale si

informatë rreth menaxhimit të mbeturinave. Ne kemi kërkuar edhe nga dy kompanitë: "Ekoregjioni" dhe "Ekodrinia" që së paku në muajt e fundit të raportojnë në 11 pika, që i kemi përcaktuar si prioritete nga komuna e Rahovecit. Për të gjitha pyetjet tuaja, jam këtu për përgjigje.
**Ilir Pallqa:** Javën e kaluar kam qenë te deponia legale, i kam hedhur disa mbeturina. E pyeta atë burrin aty, i thashë: prej herës së kaluar që isha, a kanë ardhur më shpesh? Ndoshta ma bëri rrafsh, por u përgjigj: "Kanë ardhur më shpesh, sot e diel dhe jam detyruar të dal". Herën e parë që kam qenë, kam postuar për t'i orientuar banorët e Rahovecit që mbeturinat me sasi të madhe t'i hedhin atje. Ju si hisedar te përgjegjësia për mbeturina, nuk keni bërë shumë në këtë drejtim, ndonjë fushatë sensibilizuese për t'i orientuar qytetarët që i pastrojnë shtëpitë me sasi të madhe mbeturinash. Merreni si këshillë dhe fokusohuni më shumë në këtë drejtim.
**Fahrije Lushi:** E kam një sugjerim rreth festivalit "HardhFest". Ju lus që t'i përgatisni rrugët në hyrje-dalje të Rahovecit dhe njerëzit që vijnë ta kenë përshtypjen e një vendi të veçantë. Pra, duhet t'i rrimë karshi festivalit, i cili ka marrë një renome botërore. Në faqen e fshatit Ratkoc, besoj e keni parë që ka mjaft deponi inerte, që njerëzit i hedhin kudo. Kërkesa ime është që t'u jepni rëndësi rrugëve dhe hapësirave më të frekuentuara nga vizitorët, më 5,6,7 shtator.
**Bejtullah Deliu:** Faleminderit, i nderuar kryesues! Drejtorë të drejtorive, kolegë asambleistë, medie dhe ju të pranishëm! U detyrova ta marr fjalën në lidhje me këtë pikë të rendit të ditës. Nëse i shikojmë rrugët kryesore, ku qarkullimi është më i shpeshtë, besoj që çdo vit ka përmirësim të dukshëm në vetëdijesim të popullatës në hedhjen e mbeturinave. Pajtohem me kërkesën e Ilirit, kur jemi te pastrimi i shtëpive dhe kemi sasi të madhe të mbeturinave, këtu ndoshta kemi mungesë të vetëdijesimit. Ndoshta qytetarët nuk janë të njoftuar siç duhet dhe për këtë arsye ndodh që mbeturinat t'i hedhin në pronë private edhe pse kanë mundësi t'i hedhin në deponi legale. Besoj që këtu kemi ngecje të vogël, përndryshe, në këtë aspekt jemi komunë që duhet të lavdërohemi.
**Përparim Krasniqi:** Disa vërejtje ishin me vend, por ju njoftoj që Komuna e Rahovecit për pastërti qëndron mirë në nivel kombëtar. Kjo gjë është dëshmuar nga Agjencia e Statistikave të Kosovës, si dhe ka parametra që janë marrë edhe nga organizatat e huaja. Kemi bërë sensibilizim dhe thirrje përmes faqes zyrtare, kemi bërë tabela në rrugë. Fahrije Lushi pyeti për pastrimin e rrugëve. Ne i kemi pastruar edhe rrugët rajonale, të cilat janë në kompetencë të ministrisë. Sidoqoftë, aty ku keni vërejtje dhe informata është mirë që t'i drejtoheni edhe inspektoratit komunal. Së fundi, përmes Drejtorisë së Urbanizmit kemi filluar një fushatë ndërgjegjësuese nëpër shkolla.
